



**Lënda : REALIZIMI I TREGUESVE EKONOMIKO FINANCIARË  
GJATË NËNTËMUJORIT TË VITIT 2019**

**Drejtuar : Z.Thoma GËLLÇI  
DREJTORI I PËRGJITHSHËM RTSH**

**BORDIT TE ADMINISTRIMIT RTSH**

Realizimi i treguesve bazuar në Vendimin nr.1 datë 15 Shkurt 2019, mbi miratimin e buxhetit të RTSH për vitin 2019.

**I.Realizimi i të ardhurave në krahasim me planifikimin gjatë 9/Mujorit të vitit 2019  
Në 000/lekë**

TE ARDHURAT	Plani Buxheti Viti 2019	Plani 9/Mujori Viti 2019	Realizimi 9/Mujori pare 2019	% realizimi
<b>I Financimi nga buxheti</b>	<b>615,000</b>	<b>485,000</b>	<b>485,000</b>	<b>100%</b>
Bashkatdhetarët&Sateliti	240,000	188,200	188,200	100%
Projekte Filmike&Artistike	65,000	12,000	12,000	100%
Orkestra Simfonike RTSH	60,000	54,800	54,800	100%
Shërbim mirëmbajtje rrjeti digjitaliz.,etj	200,000	180,000	180,000	100%
Investime në Teknologji	50,000	50,000	50,000	100%
<b>II.Të ardhura nga tarifa aparatit televiziv</b>	<b>1,400,000</b>	<b>1,050,000</b>	<b>940,254</b>	<b>90%</b>
<b>III.Të ardhura te institucionit</b>	<b>375,000</b>	<b>275,000</b>	<b>197,246</b>	<b>72%</b>
Sherbim ambjentet transmetuese,tr.fm	147,000	110,000	58,270	53%
Reklama,njoftime etj.	95,000	70,000	42,976	61 %
Të ardhura të tjera	57,000	35,000	36,000	103%
Të ardhura Kontrata me Kinën	76,000	60,000	60,000	100%
<b>TOTALI I+II</b>	<b>2,390,000</b>	<b>1,810,000</b>	<b>1,622,500</b>	<b>90%</b>

***Të ardhurat janë realizuar në masën ~90% në krahasim me planifikimin ose me një mungesë në vlerë absolute 188milion lekë.***

***1-Të ardhurat nga buxheti janë realizuar në masen 100%.***

Financimi buxhetor i tërhequr si nëntëmuor përbën 78.90% ndaj totalit të planifikimit vjetor.

Realizimi i financimit nuk ka hasur në problematika dhe parashikohet i tille deri në fund të vitit.

Eshte realizuar 100% zeri *investime ne Teknologji.*

Ne muajin Tetor realizohet fondi i financimit buxhetor per zerat Orkestra Simfonike dhe Sherbimi i mirembajtjes se rrjetit digjital. Financimi buxhetor per keto dy zera mbulon vetem





periudhen 10 mujore, e kjo sjell si pasoje qe shpenzimet e dy muajve te fundit te perballohen nga te ardhurat e veta te RTSH.

Vlerat e mbetura ne zerin e Bashkatdhetarët&Sateliti 52 milion leke dhe Projekte Filmike e Artistike 53 million leke mbeten te realizohen gjate tremujorit te fundit.

**2.E ardhura nga tarifa e aparatit tv** është realizuar në masen 90% ,**me nje mungese nga planifikimi ne vlerë absolute 109,7 milion lekë.** Arkëtimet vijoje me luhatje nga një muaj në tjetrin dhe realizimi mesatar paraqitet në vlerën ~104 milion lekë/muaj,nga 117 milion leke ne muaj qe ishte parashikimi ne fillim te vitit.

Nëse arkëtimi vijon në kete trend , vlera e munguar në buxhetin e vitit 2019 parashikohet rreth 140 milion lekë.

**3.Të ardhurat e RTSH paraqiten te realizuara ne masen 72%,ose me një mungesë në vlerë absolute ~78 milion lekë.**

**Ne menyre analitike realizimi paraqitet si vijon :**

**a.Të ardhurat nga shërbimi në ambientet transmetuese të RTSH dhe transmetime fm** janë realizuar në masën ~53% ose me një mungesë në vlerë absolute **51.7 milion lekë.**

Mosrealizimi i ketyre te ardhurave krahasuar me planifikimin vjen si rezultat i faturimit te sherbimit vetëm vetem per tre allotmente, per periudhen Janar-Gusht 2019. Niveli i riskut eshte ulur disi gjate muajit shtator me faturimin qe ka kryer RTSH edhe për allotmentin e Tiranës.

Niveli mesatar i faturimit paraqitetet ~50%me i ulet krahasuar me planifikimin ne fillim te vitit.

**Duke analizuar kontratat e lidhura deri tani me operatorët sipas allotmenteve, risku i mosrealizimit parashikohet ne vleren rreth 65 million leke deri ne fund te vitit 2019.**

a.1 Realizimi i ketyre te ardhurave krahas problematikave te mesiperme, paraqet edhe detyrime te paarketuara nga subjektet debitore, ndjekja e te cileve perben objektiv kryesor per RTSH.

NR	SUBJEKTET	DETYRIMI
1	Top Albania	3,483,065
2	Tv Apollon	1,732,566
3	Focus media News	2,934,956
4	Multiscreen shpk	2,519,885
5	Ministria Mbrojtjes	540,000
6	Extra Channel	2,505,105
7	Drejt.Rajonale Kufirit Gjirokaster	72,000
8	Guarda di finanza	36,000
9	UTV Education	524,122
10	Shoqeria Egnatia	478,393
11	Merlin Communication	1,005,300
12	Insit.Ekz.Vepr.Penale Lezhe	36,000
13	Insit.Ekz.Vepr.Penale Korce	36,000
14	Alban Shehu	104,030





15	Plus Communication	316,356
16	Drejt.Policise qarkut Vlore	108,000
17	Abisnet	180,000
18	UNDP	192,000
19	Sherbimi Informativ shteteror	240,000
20	Shoqeria TV Sot	348,642
21	Pellumb Maci	108,000
22	Drejtoria Pergjithshme Burgjeve	108,000
23	TV Klan	207,552
24	Radio Kan	258,557
25	Skorpion shpk radio maria	348,374
26	Drejt.policise Qarkut elbasan	66,000
27	Shoqeria Fax Media News	314,457
28	Shoq.3DS&AF Entertainment	314,457
29	BBF	314,458
30	RTV Adria med	314,458
31	banka Shqiperise	180,000
32	G2 Media	625,081
33	TV Kukes	314,457
34	Scan sha	801,678
	<b>TOTALI</b>	<b>21,667,949</b>

*Ne detyrimin e mesiperm eshte perfshire edhe faturimi i muajit shtator ne vleren prej 8.37 million leke,detyrim i pritshem te arketohet ne periudhen ne vijim.*

Vlera 10.2 milion lekë është vlera e munguar nga sherbimi që RTSH u ka kryer subjektetve që vjen kryesisht nga kontratat e operatorëve që janë mbështetur në rrjetin tone në allotmentetet e Fierit,Beratit e Lushnjës. Si hap i domosdoshem mbetet ndjekja e situates se detyrimeve nga Njesia Teknike , ne menyre qe te arketohen brenda afateve dhe konform kontratavete gjitha detyrimet; si edhe bashkeveprimi me Drejtorine Juridike per nisjen e procedurave gjygesore per subjektete qe nuk realizojne kontratat.

*b.Në zërin e reklamave, njoftimeve* etj, gjatë kësaj periudhe ka një realizim në masen 61.4%, ose një mungesë në vlerë 27 milion lekë. Ecuria e te ardhurave te ketij zeri eshte ne nivele te uleta realizimi,ndonese nga Drejtoria Marketingut ishte parashikuar realizimi ne nivelin 100% te ketij zeri. Problematika ka lindur gjate zbatimit te kontratave,kryesisht me tre subjekte Sicred(14,150,000 leke )Albtelekom(7,200,000 leke) dhe Sigal (5,584,000 Leke).Gjate kesaj periudhe vlera e munguar e sherbimit per tre subjektet eshte 17,572,000 leke, pasi subjektet nuk kane sjelle spotet e parashikuara.

Niveli mesatar i faturimit paraqitetet ~50%me i ulet krahasuar me planifikimin ne fillim te vitit. Risku i realizimit të të ardhurave të këtij zëri në kufijte e planifikimit vazhdon të qendrojë i lartë. Në këtë zë janë përfshirë edhe të ardhurat nga kontratat për ripërsëritjen e transmetimit nga subjektet kabllore në vlerën 2,506,608 lekë.





*Nisur nga ecuria e deritanishme, vecanerisht realizimi i ketij zeri ne muajit Korrik e Gusht 2019, te ardhurat e pritshme te ketij zeri per vitin 2019 paraqiten me nje risk ne mosrealizimin e planifikimit vjetor ne vleren ~ 25 milion leke.*

b.1 Realizimi i ketyre te ardhurave krahas problematikave te mesiperme, paraqet edhe detyrime te paarketuara nga subjektet debitore, ndjekja e te cileve perben objektiv kryesor per RTSH.

NR	SUBJEKTET	DETYRIMI
1	Gogel	4,243,803
2	Ogilvy	1,308,000
3	De Holding	306,725
4	Landmark Communication	530,792
5	QAFE SHTAMA	473,031
6	ehw	205,800
7	Ovation Advertising	425,842
8	Red Bull	197,944
9	Teleshop	105,147
10	ERT	105,000
11	TIBO	100,089
12	Dila shpk	100,000
13	Birra Tirana	50,000
14	Tilux	68,781
15	Eurosig	2,468,303
16	Raiffeisen	6,090
17	Agjensia Telegrafike Shqiptare	360,000
18	Telekom Albania	636,000
19	Coca Cola	169,600
20	United Albania Breweries	252,831
21	Unlimited Media	1,959,507
22	Refleksione	45,000
23	Hygea Hospital	36,000
24	Kompania Armata Kollektive	31,800
25	Aima Sha	32,783
	<b>TOTALI</b>	<b>14,218,868</b>

Detyrime te ktijuara ne muajin shtator dhe te pritshme te arketohen ne periudhen ne vijim jane ne vleren 4,8 milion leke. Vlera 9,4 milion leke qendron ne kufij relativisht te larte dhe mbetet objekt i ndjekjes nga Drejtoria e Marketingut ne bashkepunim me Drejtorine Juridike. Rreth 50% e ketij detyrimi mbartet nga viti 2018.





### Detyrimet e mbetura nga kontratat e shkëmbimit

NR	Kontrata shkëmbimi	Vlera
1	Tabbako Holding	1,893,650
2	Megatek	76,552
3	Neptun	539,138
4	VEKO	889,057
5	Ora News	1,257,700
6	Channel One	1,257,700
7	extra channel	1,951,790
8	DEUTSCH COLOR	1,801,867
9	Focus Media (news 24)	955,100
10	Radio Televizioni Kosoves	4,781,000
11	ECOMARKET	503,161
12	Radio +2 Abisnet	858,558
13	Studio Moderna Albania	155,340
14	DELTA	126,882
	<b>Totali</b>	<b>17,047,495</b>

### Detyrime Subjekte per ndjekje nga DREJTORIA JURIDIKE

Nr.	Subjekte	Detyrime
	<b>Subjekte që janë në përmbarrim</b>	<b>3,707,756</b>
1	Media Art	134,994
2	Centrum Production	375,333
3	Kompania MCDR Shiroka	400,000
4	Star Airways Albania	157,205
5	2 AL shpk	815,000
6	Menocon internet	292,000
7	KESH	499,500
8	“ALSAT” sh.a.	115,724
9	Alfatelekom	918,000
	<b>Subjekte në Proces gjyqësor</b>	<b>5,488,675</b>
1	<i>Teknomedia Nesor TV</i>	<i>1,175,143</i>
2	<i>4 Plus media group</i>	<i>1,116,234</i>
3	<i>Emiliano Hoxhaj</i>	<i>1,102,468</i>
4	Shoqeria Ora sha	146,121
5	<i>Shoqeria Channel one shpk</i>	<i>510,829</i>
6	Gener 2	1,062,880
7	Kelmend	375,000
	<b>Fituar e në proces gjyqësor per t'u arkëtuar</b>	<b>9,196,431</b>

Detyrimet që po ndiqen me procese gjyqësore janë shtuar me vleren ~5,5 milion lekë , pasi me gjithë njoftimet e herëpashershme subjektet nuk kanë kryer as likuidime pjesore per detyrimet per sherbime ne infrastrukturen e RTSH dhe reklama.

*Procedurat gjyqësore kane perfunduar per Subjekti Drejtoria Policise Qarkut Vlore , duke bere te mundur edhe arketimin e detyrimit te ketij subjekti ne vleren 330,740 leke.*





*c.Në zërin e të ardhurave të tjera* janë realizuar të ardhurat e parashikuara në nivelin 102.8%. Realizimi i këtij zëri parashikohet të jetë edhe në vijim në nivelin e planifikuar, nisur edhe nga ecuria e viteve të tjera.

*Ecuria e deritanishme e te ardhurave te realizuara si edhe arketimeve nga te tretet, vijojne te krijojne veshtiresi ne perballimin e shpenzimeve.*

*-Mungesa e realizimit te te ardhurave gjate periudhes nentemujore paraqitete ne vleren ~ 188 milione leke*

*- Vlera e detyrimeve te pritshme te arketohen ~45 milione leke*

**Situata me detyrimet ne menyre te permbledhur paraqitet :**

-Vlera~ 35,8 milion lekë është detyrim i pritshëm të arkëtohehet .

-Vlera ~ 9 milion lekë është duke u ndjekur në rrugë gjygesorë

-Vlera ~ 17 milion lekë mbetet të realizohet nga kontratat e shkëmbimit 2018,2019.

-Vlera ~ 40,5 milion leke per detyrime te mbartura nga vietet e kaluara ,te fituara ne procese gjygesore por pa adrese; si edhe det.te prapambetura te papranuara nga subjektet,per te cilat ka kaluar afati i parashkrimit

### III.Realizimi i shpenzimeve në krahasim me planifikimin gjatë 9/mujorit 2019

në 000/lekë

Emertimi	Planifikimi Viti 2019	Planifikim i 9/muj. Viti 2019	Realizimi 9/muj. Viti 2019	% Realizimit
Paga,shpërblime ,sig.shoqeror	801,150	582,768	577,353	99
Materiale,lende djegese	66,500	57,280	55,864	97.5
Projekte film.,artistike ,bl.dr.tv,f.p.pav. etj	317,000	254,774	241,707	94.8
Organizma Nderkombetar	87,000	77,000	76,463	99.3
Shërbime nga të trete	235,050	167,294	166,573	99.6
Shpenzime udhëtimi e dieta	86,500	67,686	64,720	95.6
Shpenzime të tjera operative	71,800	57,390	53,114	92.5
Investime dhe miremb. rrjeti digj.	395,000	337,500	295,879	87.67
Shpenz.këste e interesa kredie	330,000	320,000	819	
<b>TOTALI</b>	<b>2,390,000</b>	<b>1,921,692</b>	<b>1,532,492</b>	<b>79.7</b>

Realizimi i planit te shpenzimeve paraqitetet në masen 80%. Duke zbritur kredinë , e cila u likuidua nga Ministria Financave edhe ne muajin Shtator 2019, realizimi i planit te shpenzimeve paraqitet ne masen 96%.

Të gjitha shpenzimet janë realizuar bazuar në nivelin e të ardhurave të RTSH-së.

**1.Zeri Paga,Mbikohe,sigurime shoqërore e shpërblime .**Gjate periudhes nentemujore realizimi i ketij zeri ka qendruar ne nivelin e planifikimit dhe te gjitha ndryshimet strukturore jane kryer brenda limiteve te planifikimit.Perqindja e realizimit ndaj totalit te ketij zeri qendron ne





nivelin 72%. ***Ndryshimet strukturore kerkojne ndryshime vetem brenda strukturave te vartesise, kryesisht ndermjet Njesise se Programeve ne pakesim ne vleren 15 milion leke dhe Njesise Tematike dhe Lajmeve ne shtese ne vleren 8milion leke.***

Nisur nga ecuria nentemujore dhe planifikimi per periudhen Tetor-Dhjetor 2019 niveli i realizimit te ketij zeri parashikohet ne vleren totale prej 790 milion leke.

***Vlera 10 milion lekë mbetet per t'u rishperndare ne zërat e tjerë tëshpenzimeve në buxhet.***

**2.Shpenzime materiale e lëndë djegëse.**Realizimi i ketij zeri ne total eshte brenda limiteve te planifikimit, por paraqet ndryshime brenda struktures se tij per shpenzime materiale dhe lende djegese.Krahasuar me planin vjetor perqindja e realizimit te ketij zeri eshte ne nivelin 84%.Ky fond parashikohet te realizohet 100% deri ne fund te vitit. Tejkalimet e zerit te karburantit(ne vleren ~3 milion leke si nentemujor),si rezultat i mungesave te energjise elektrike dhe shtimit te numrit te depozitave mbeten te kompensohen brenda parashikimit te zerit materiale kryesore e ndihmese.Njesia Teknike e RTSH ka paraqitur kerkesa shtese per vleren 6 milion leke materiale, por ndodhur perballe ketyre problemeve eshte e pamundur te planifikohet nje shtese fondi ne kete vlere.Ne varesi te realizimit cdo muaj do te shihet mundesia per rishperndarje vetem per vlera pjesore gjate ketij viti.

**3.Zëri projekte Filmike,Artistike,blerje të drejta televizive.**Realizimi i ketij zeri eshte bere gjate periudhes nentemujore perben ~76% te planit vjetor.Vlera e mbetur 76 milion leke (perfshire ketu edhe fondin e prodhimit te pavarur)perfshin vleren e festivalit te kenges RTSH ,programet e fund vitit dhe vetem pjeserisht projektet e miratuara deri ne kete periudhe . Parashikimi per kete ze per vitin 2019 eshte si vijon :

-Projekte artistike,filmike,bashkeprodhime	165,000,000 leke
-Blerje te drejta televizive	135,000,000 leke
-Fondi prodhimit te pavarur	17,000,000 leke

**Gjatë periudhës nëntëmujore janë realizuar :**

-Projekte artistike,filmike,bashkeprodhime	106,806,000 leke
-Blerje te drejta televizive	135,000,000 leke
-Fondi prodhimit te pavarur	0 leke

**Vlera e mbetur për periudhen Tetor-Dhjetor është ~76,000,000 lekë, nga të cilat :**

-Projekte artistike,filmike,bashkeprodhime	58,000,000 leke
-Fondi prodhimit te pavarur	17,000,000 leke

*Vlera ~58 milion leke eshte vlera e mbetur per projekte filmike e artistike, nga te cilat 53 milion leke do te terbiqen nga financimi buxhetor parashikuar per festivalin e kenges RTSH,programet e fundvitit ,serial tv etj.*

*Vlera 17 milion leke parashikohet nga fondi i prodhimit te pavarur nuk eshte realizuar deri ne kete periudhe.Bashkengitur eshte edhe nje liste e projekteve te Zyres se projekteve te miratuara gjate*





periudhes nentemujore. Bazuar ne projektet e miratuara ne kete ze situata paraqitet me nje risk te larte, pasi kerkon edhe fonde shtese, si edhe nje plan te prioriteteve se si do te operohet me projektet e miratuara deri tani.

**4.Zëri i shpenzimeve ndajr Organizmave Nderkombetare** Realizimi i ketij qendron ne nivelin e planifikimit. Realizimi i tij kundrejt planifikimit vjetor perben ~87.8% si edhe parashikohet te realizohet brenda limiteve te planifikimit deri ne fund te vitit.

**5.Zëri i shërbimeve nga të tretë.**Realizimi i kyre zeri analizohet ne menyre analitike ne te gjithë komponentet perberes te tij, pasi ndonese ne total paraqitet i realizuar brenda zerave ka tejkalime dhe mosrealizimi , te cilat mbeten objekt sistemimi .

Realizimi ne total per zerat energji elektrike,uje,shp.telefonike,sherbimi i ruajtjes fizike dhe qerate qendron brenda limiteve te planifikimit nentemujor, ndersa si rezultat i shtimit te numrit te stacioneve ne kuader te digjitalizimit qendron ne nivele mbi planin realizimi i shpenzimeve te energjise elektrike.Deri ne fund te vitit parashikohet qe ky ze te kete nje mungese ne vleren ~3-4 milion leke, vlere e cila mund te kompensohet nga elementet e tjere te shpenzimeve brenda ketij zeri.**Në këtë zë përfshihet edhe nën zëri i shpenzimeve të tjera**

Parashikimi vjetor per kete ze qendron ne vleren 49,605,000 Leke si vijon:

**-Shpenzime të drejta Autori ~13,000,000 leke**

**-Shpenzime transmetimi ~13,000,000 leke**

**-Shp.Trajnime,Shp.gjygesore,10% prures reklame,Sherbimi OTT ,si edhe shpenzime te tjera operative (taksa, siguracione etj.) 23,605,000 LEKE**

*Gjatë periudhës nëntëmujore ky zë paraqitet i realizuar si vijon:*

Shpenzime te drejta autori : 9,920,000leke,

Digitalb kosto transmet. : 8,800,000leke

Shp.te tjera: Siguracione,taksa mak. 3,580,000 leke; Shpenz.gjygesore 3,000,000 leke; Mirmb.rrejeti MC network. :2,500,000 leke; Shp.riciklimi tend.ankandi 1,470,000 leke; Shp pruresi reklames 2,837,000 leke, qera salle, led wall, pajisjesh, shp bileta, orkestra( sherbime per instrumentat), logot ,aplikime per asete ne rrethe, komisione etj. ne vleren 4,136,000 leke

**Drejt.pergj.RTSh 36,243,000 leke**

**Njesia Teknike 4,800,000leke**

**Njesia programeve 2,900,000 leke**

---

**Totali nentemujor : 42,900,000 leke**







Vlera e mbetur e ketij fondi 6,7 milion leke, mbetet te perdoret ne periudhen ne vijim per perballimin e kostove te transmetimeve te ndeshjeve te futbollit, si edhe zerave te planifikuar bazuar ne kontratat ekzistuese, vlere e cila eshte shume e ulet ,krahasuar me periudhen e ngarkuar te tremujorit te fundit.

**6.Zëri i shpenzimeve udhëtim e diëta** eshte realizuar brenda kufijve te planifikimit dhe parashikohet i tille deri ne fund te vitit.

**7.Zëri i shpenzimeve të tjera operative** paraqitet i realizuar ne masen 73,9% kundrejt planit vjetor te ketij zeri. Nisur nga ecuria e deritanishme e shpenzimeve, realizimi parashikohet te jete ne vleren 61 milion leke, **duke krijuar keshtu mundesine e rishpendarjes ne zerat e tjere te vleres 10 milion leke.**

### **8.Zëri shpenzime të mirëmbajtjes së rrjetit dhe investimeve**

Shpenzimet ne zerin e sherbimit te mirembajtjes se rrjetit te digjitalizimit parashikohen te realizohen brenda kufijve te planifikimit.RTSH. Gjate vitit 2019 mbarti te palikuiduar sherbimin per periudhen shtator-dhjetor 2018, e per pasoje nisur edhe nga buxheti i ketij viti dhe ecuria e arketimeve, parashikohet qe situata te vijoje e tille e te mbartet minimalisht nje detyrim dymujor(tetor-nentor) ne vitin qe vjen.

-Në zërin e investimeve janë mbyllur procedurat me buxhetin e shtetit per investimet e parashikuara.Nderkohe Njesia e Prokurimeve ka nisur procedurat e tenderimit per vleren e mbetur per t'u financuar nga te ardhurat e RTSH.

Me perfundimin e procedurave te tenderimit, do te shihet edhe mundesia e ndonje vlere sado te vogel te mbetur te ketij fondi, per t'u rishperndare kryesisht ne zerin materiale, per te plotesuar dhe emergjencat e krijuara kryesisht ne Njesine Teknike.

Në mënyrë të përmbledhur , duke analizuar situatën e deritanishme të të ardhurave dhe shpenzimeve, risku i realizimit të buxhetit të RTSh gjatë këtij viti vijon të paraqitet i lartë.

RTSH eshte perpjekur te likuidoje gjitha detyrimet kontraktore , por ndodhet shpeshhere para faktit te mosrespektimit te afateve te likuidimit, si rezultat i mungeses se aftesise likuiduese ne afatet e parashikuara.

***Nga analiza e zerave te shpenzimeve,mundesia e rishperndarjes brenda buxhetit aktual eshte ne vleren 20,000,000 leke.***

#### ***Detyrimet që RTSH ka ndaj të tretëve paraqiten:***

-Ministria e Financave	3,997,869.19 Euro ose 495,7 milion leke (tre keste kredije 2018-2019)
-Rohde Schartz SLA	495,000 Euro ose 60 million leke( korrik-shtator 2019)
-Eutelsat	17,485 Euro
-EBU	3,500 Euro
-Straight.. drejta tv	42,000 Euro
-AFP	1,974 Euro
-Kosova Press	1,900 Euro
-Telekom	292,000 leke
-Bolv Oil	7,715,232 leke
-International Securiti Albania	3,367,160leke
-Federata shqiptare e Futbollit	1,879,300 leke

---

<b>Totali</b>	<b>4,559,729 Euro</b>	<b>13,253,692 leke</b>
---------------	-----------------------	------------------------





Nisur nga ecuria e deritanishme e arketimeve RTSH paraqet edhe nje Cash Flow per periudhen ne vijim :

<b>CASH FLOW TETOR - DHJETOR 2019</b>			
<b>Periudha</b>	<b>tetor</b>	<b>nentor</b>	<b>dhjetor</b>
Gjendje ne banke	80,000,000	87,700,000	88,400,000
<b>TE ARDHURAT</b>			
Financimi Buxhetor	40,000,000	40,000,000	45,000,000
antena	5,000,000	5,000,000	5,000,000
reklammat	5,000,000	5,000,000	5,000,000
rimbursimi china etj.	1,200,000	1,200,000	1,200,000
taridfa ap.rtv	100,000,000	100,000,000	100,000,000
te tjera Eutelsat,China		15,000,000	
<b>TOTALi ardh.</b>	<b>231,200,000</b>	<b>253,900,000</b>	<b>244,600,000</b>
<b>SHPENZIMET</b>			
Pagat,Sigurime ,shperblime	66,000,000	66,000,000	80,000,000
energjia	7,000,000	8,000,000	8,000,000
Projekte filmike artistike,DR.TV	6,000,000	7,000,000	63,000,000
rojet civile	4,500,000	4,500,000	4,500,000
Udhetim e dieta	7,000,000	7,000,000	7,000,000
Qera	2,000,000	2,000,000	2,000,000
Honorare	5,000,000	5,000,000	5,000,000
karburant	8,000,000	-	
Eutelsat,Ebu	7,000,000	5,000,000	6,000,000
Materiale	3,000,000	3,000,000	3,000,000
Te tjera	7,000,000	12,000,000	7,000,000
Mirembajtaja	21,000,000	21,000,000	21,000,000
Investime		25,000,000	25,000,000
<b>TOTALi shpenz.</b>	<b>143,500,000</b>	<b>165,500,000</b>	<b>231,500,000</b>
	87,700,000	88,400,000	13,100,000

Tabela e mesiperme jep vetem nje parashikim te perafert, nese deri ne fund te vitit ecuria e te ardhurave dhe shpenzimeve do te ndjeke kete realizim cash-flow.

Situata veshitresohet nese ndodhemi perballe faktit te mosrealizimit te te ardhurave , si edhe voneses ne arketim te tarifes se aparatit tv ne muajin dhjetor,e cila penalizoi RTSH ne vitin 2018, duke mbartur detyrimet per paga, sla, investime etj. ne vitin 2019.

